

URDHËR
Nr. 300, datë 19.6.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 31, DATË 28.1.2020,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN
E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë; nenit 26 të ligjit nr. 69/12, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Nina Guga”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Në rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e urdhrit nr. 31, datë 28.1.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar” të zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar” dhe shkurtimet “DPAP” dhe “ZVA” të zëvendësohen përkatësisht me “AKAP” dhe “ZVAP”.

2. Pikat 2 dhe 3 të nenit 7 ndryshohen si vijon:

“2. Fëmija që mbush moshën 6 vjeç deri në datën, kur fillon viti shkollor, përfshihet në detyrimin për ndjekjen e shkollës. Fëmija ka të drejtë të regjistrohet në klasën e parë edhe kur mbush 6 vjeç deri më 31 dhjetor të po atij viti kalendarik.

Regjistrimi në klasën e parë bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, sipas afateve të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

3. Drejtuesit e institucioneve arsimore, nëpërmjet personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionet Parauniversitar, verifikojnë vijueshmërinë e nxënësve të klasave të ndërmjetme të arsimit bazë, për vitin e ardhshëm shkollor.”.

3. Pika 1 e nenit 12 ndryshohet si vijon:

“1. Regjistrimi në klasën e dhjetë bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, sipas afateve të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.”.

4. Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Neni 13

Pranimet në shkollat e arsimit të mesëm të orientuar me konkurs

1. Në shkollat artistike dhe ato sportive nxënësit pranohen vetëm me konkurs.
2. Pranimet në shkollat artistike dhe ato sportive rregullohen me udhëzim të ministrit.
3. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore aplikon nëpërmjet portalit *e-Albania*, për regjistrimin në konkursin për pranimin e nxënësve në klasën e dhjetë, sipas afateve të përcaktuara nga AKAP-ja.
4. Shkollat pranojnë nxënës për konkurrim edhe nga NJVV-të e tjera.
5. Kur një nxënës fitues nuk paraqitet në shkollë brenda 5 (pesë) ditëve nga fillimi i vitit shkollor për shkaqe të pajustificuara, nxënësi tjetër, sipas radhës në listë, gëzon të drejtën e pranimit në shkollë.”.

5. Pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 78 ndryshojnë si më poshtë:

“3. Transferimi i nxënësve bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, me plotësimin e formularit nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit dhe i drejtohet drejtorit të IA-së ku nxënësi është regjistruar.

4. Lëvizjet e nxënësve bëhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në SMIP.

5. Dokumentacioni i transferimit, i cili sigurohet nga struktura përgjegjëse me ndërveprim përmes SMIP-it, përmban:

- a) vlerësimet/notat e nxënësit të marra gjatë vitit shkollor deri në çastin e transferimit;
- b) numrin e mungesave të arsyetuara dhe të paarsyetuara;
- c) nderimet ose/dhe masat disiplinore ndaj nxënësit.”.

6. Neni 109 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 109, Regjistri digjital i klasës, dëftesat digjitale të klasave, amza digjitale:

1. Regjistri i klasës është digjital dhe krijohet e plotësohet në SMIP.
2. Regjistri i klasës plotësohet sipas rubrikave në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
3. Mësuesi kujdestar i klasës dhe mësuesit që japin lëndë mësimore në klasën përkatëse, plotësojnë rubrikat e regjistrit digjital të klasës, sipas afateve të përcaktuara në SMIP.

4. Administratori i SMIP-it për shkollën krijon regjistrin për secilën klasë dhe ushtron përgjegjësitë e kryen detyrat, sipas rregullores për SMIP-in, të miratuar me urdhër të ministrit për arsimin.

5. Mësuesit (kujdestarë klase dhe lëndësh) përdorues të regjistrit digjital ushtrojnë përgjegjësitë dhe kryejnë detyrat sipas rregullores për SMIP-in, të miratuar me urdhër të ministrit për arsimin.

6. Pajisen me dëftesë digjitale të klasës të gjithë nxënësit e klasave I–IX dhe të klasave X deri te klasa e parafundit e arsimit të mesëm të lartë.

7. Dëftesa digjitale e klasës dhe ajo e mbarimit të shkollës gjenerohen nga portali *e-Albania*.

8. Shkolla pajis nxënësin/ish-nxënësin me vërtetim të rezultateve të shkollimit, me kërkesë të tij.

9. Pajisen me certifikatë dhe diplomë të Maturës Shtetërore të gjithë nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë. Certifikata dhe diploma e Maturës Shtetërore gjenerohen nga portali *e-Albania*.

10. Drejtori kujdeset dhe mban përgjegjësi për amzën digjitale, sipas rregullores për SMIP-in, të miratuar me urdhër të ministrit për arsimin.

11. Plotësimi i amzës digjitale kryhet sipas përcaktimeve në rregulloren për SMIP-in, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

12. Për shkollat e mbyllura, regjistri i veçantë, amza dhe indeksi i amzës dorëzohen nga drejtori i IA-së nën kujdesin e ZVAP-së përkatëse në arkivin vendor, menjëherë me hyrjen në fuqi të aktit të mbylljes.”.

7. Shtojcat nr. 2, nr. 4 dhe nr. 5, shfuqizohen.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Nina Guga